

Paraja elektronike: E ardhmja e parasë?

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

në qoftë se dëshironi të keni kopje të shkruara të tij mund t'i kërkonit në adresën:

Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej" Nr.1 Tiranë, Shqipëri,

Tel.: +355-(0)4-222152;

Faks: +355-(0)4-223558

ose duke dërguar një e-mail në adresën:

public@bankofalbania.org

Tirazhi: 6000 kopje

Përmbajtja

Të dashur lexues	5
Hyrje	7
Paraja sot	9
Si përkufizohet paraja elektronike dhe si ka lindur ajo?	10
“Lojtarët” në qarkullimin e parasë elektronike	12
Pjesa teknike: Si mundësohet paraja elektronike?	14
A ekzistojnë lloje të ndryshme të parasë elektronike?	16
Përparësitë e parasë elektronike	19
Disavantazhet e parasë elektronike	20
Përdorimet në jetën e përditshme të parasë elektronike	24
Paraja elektronike në Shqipëri	26
Botime edukative të Bankës së Shqipërisë	28

Të dashur lexues,


Që kur njeriu ka filluar të shkëmbejë, “paraja” e përdorur ka qenë e shikueshme dhe e prekshme nga secili. Njerëzit përgjithësisht, besojnë në diçka që e shohin dhe e ndjejnë. Çfarë është diçka që mund t’i bëjë të besojnë edhe përtej kësaj? Dobishmëria, lehtësia e përdorimit, siguria, personalizimi, aftësia e të shndërruarit nga një send i zakonshëm në një mundësi pagese, me kufij të përcaktuar nga mundësitë e secilit dhe nga “marrëdhënia” e tij me bankën.

Deri më sot njihet vetëm një mjet i tillë, që tashmë ka fituar të drejtën e qytetarisë së përdorimit nga miliona e miliona qytetarë të botës, dhe kjo është paraja elektronike. E krijuar për të qenë një mënyrë pagese e thjeshtë për përdoruesin por që kërkon një nivel të caktuar të zhvillimit të teknologjisë bankare, paraja elektronike mund të shihet si një “konkurrente – armike” e parasë tradicionale. Përkundrazi, ajo është vetëm një mundësi më shumë për të kryer më lehtësisht pagesa apo për të transferuar para.

Vitet e fundit, me përhapjen dhe zhvillimin e teknologjisë dhe me rolin që interneti dhe rrjetet e tjera kompjuterike kanë në jetën e gjithsecilit, duket se paraja po bëhet gjithmonë e më shumë elektronike. Internet banking, kartat e debitit dhe të kreditit, pagesat elektronike të faturave, po bëjnë që cash-i apo paraja tradicionale të zhvendoset nga qendra e skenës, për t’i bërë vend një tjetër aktori, me më shumë përparësi.

Për të njohur publikun me këtë formë të re të parasë dhe karakteristikat e saj, Banka e Shqipërisë ka përgatitur broshurën në vijim, të cilën ju ftoj ta lexoni.

Ardian Fullani
Governator





Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani.

Hyrje

“Cash fillon tek unë! Tani unë kam mundësi të paguaj faturat e dritave, ujit, telefonit etj., pa patur nevojën e përdorimit të parasë *cash*”. Kështu shkruhet në një fletëvolant të përgatitur nga Banka e Shqipërisë.

Tashmë, modernizimi i sistemit bankar ofron mundësi të shumta për mënjanimin e përdorimit të parasë *cash*. Një prej këtyre mundësive është përdorimi i parasë elektronike. Për të krijuar një ide më të qartë mbi këtë mundësi, Banka e Shqipërisë i ofron të gjithë përdoruesve të *cash*-it informacion bazë mbi këtë formë të re të parasë, avantazhet, disavantazhet e saj dhe mënyrat e ndryshme të përdorimit.

Në përgjithësi, informacioni në vijim është shkruar në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme. Megjithatë, për më kureshtarët, duke patur parasysh teknikalitetin e vetë temës së trajtuar, nuk mungojnë edhe pjesë teknike. Sa herë që trajtohen çështje teknike, ato do të shoqërohen **me këtë shenjë dalluese.**

çështje teknike



"CASH" fillon tek unë



"CASH" fillon tek unë!

Paraja sot

Paraja në ditët e sotme nuk është më prej ari ose prej mineralesh të tjera me vlerë. Ajo nuk është më as gjerdan prej guaskash, as gjethe duhani apo një tufë bagëtish. Paraja është ajo që ekonomistët e përkufizojnë si “mjet pagese”, të cilin ne e shkëmbejmë për të mirat dhe shërbimet që blejmë. Njëkohësisht, paraja është njësi llogaritjeje dhe ruajtëse e vlerës.

Paraja sot merr forma të ndryshme fizike. Këto forma përfshijnë monedhat, kartëmonedhat dhe llogaritë rrjedhëse pranë bankave tregtare. Por çfarë i bën këto forma paraje të besueshme? Ne i pranojmë paratë sepse jemi të bindur që mund t’i përdorim ato për t’i shkëmbyer me mallra dhe shërbime. Kjo bindje ushqehet prej faktit që paraja është e njohur nga ligji dhe ne kemi besim të mjaftueshëm për ta pranuar atë si mjet pagese.

Megjithatë, zhvillimet e teknologjisë moderne i kanë dhënë përmasa të reja konceptit të parasë. A keni dëgjuar për paranë “e padukshme”? Në gjuhën ekonomike kjo formë e re e parasë quhet para elektronike. Nga pikëpamja ekonomike shtrohet një pyetje me interes, e cila është: Çfarë të rejash ofron paraja elektronike në krahasim me llojet tradicionale të parasë dhe instrumentet e pagesave? Edhe pse aktualisht është e vështirë të jepet një përkufizim i saktë i parasë elektronike, përsëri janë të njohura përdorimet dhe të mirat që ajo ofron.

Si përkufizohet paraja elektronike dhe si ka lindur ajo?

Paraja elektronike i referohet parasë dhe transaksioneve që kryhen me të, duke përfshirë në këto transaksione edhe mjetet elektronike. Kjo nënkupton edhe përdorimin e një rrjeti kompjuterash (si për shembull, interneti).

Është shpjeguar më gjerësisht, termi para elektronike shpeshherë i referohet një numri të madh të mekanizmave të pagesave. Të dhënat e të ardhurave të një klienti ruhen në një kartë elektronike (për shembull, një kartë debiti), e cila është pronësi e klientit. Vlera elektronike reduktohet sa herë që klienti e përdor kartën elektronike për të kryer pagesa të ndryshme. Megjithatë, në përkufizimin e parasë elektronike përfshihen si kartat me parapagesë, programet e parapagesës të cilat përdorin rrjete kompjuterash (si për shembull, internetin) ashtu edhe kartat e kreditit. Të gjitha këto, konsiderohen si mekanizma, të cilët mundësojnë qarkullimin e parasë elektronike.

Paraja elektronike mund të përdoret vetëm në mënyrë elektronike. Ajo mund të ruhet në një kartë, në një hard disk ose në mjete të tjera. Paraja elektronike nënkupton të gjitha veprimet që kryhen në mënyrë elektronike, rezultati i të cilave është kalimi i fondeve nga një llogari bankare në një tjetër.

Paraja elektronike i gjen fillimet në gjysmën e dytë të viteve '80 në Japoni. Shumëkush mund të mendojë që paraja elektronike ka lindur si nevojë e bankave tregtare. Në fakt, pionierët e parë të krijimit të kësaj paraje ishin disa kompani jobanka, të tilla




si kompanitë telefonike apo kompanitë e transportit. Arsyet kryesore të hedhjes në treg të këtij produkti ishin zëvendësimi i parasë *cash* dhe përmirësimi i shërbimit ndaj klientëve, duke fituar kështu besimin e tyre. Në vitin 1987, filluan të krijoheshin ndërmarrje të përbashkëta midis kompanive jobanka, të cilat prodhuan një kartë të përbashkët, e pranueshme në të gjitha degët e këtyre kompanive.

“Lojtarët” në qarkullimin e parasë elektronike

Përdorimi i parasë elektronike mundësohet nga sistemi i pagesave elektronike, i cili përbëhet nga: emetuesit, klientët, tregtarët dhe rregullatorët. Emetuesit mund të jenë banka ose institucione jobanka; klientët janë përdoruesit e parasë elektronike; tregtarët janë ata të cilët marrin para elektronike në shkëmbim të mallrave dhe shërbimeve që ofrojnë dhe rregullatorët, janë agjenci të lidhura me qeverinë, të cilat kanë për qëllim të ruajnë paranë elektronike nga falsifikimi ose çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me ligjin. Procesi i pagesës elektronike përmban tre faza:

- 1) Hapja e llogarisë: Klienti duhet të hapë një llogari bankare nëpërmjet një emetuesi. Tregtarët, të cilët kanë dëshirë të pranojnë para elektronike duhet të hapin gjithashtu, një llogari bankare. Rrjedhimisht, emetuesit kujdesen për llogaritë e klientëve dhe të tregtarëve.
- 2) Blerja: Klientët blejnë të mallra dhe shërbime dhe në këmbim marrin fatura vërtetimi, që përfaqësojnë vlerën e mallrave dhe shërbimeve të shprehura në para elektronike. Këto fatura vërtetimi përmbajnë informacion rreth shumës së parave të shpenzuara, llojet të këtyre parave dhe datës në të cilën është kryer blerja. Informacioni mbi blerjen ruhet në rrjetin e ngritur enkas për këtë qëllim nga emetuesit e parasë elektronike.
- 3) Vërtetimi: Emetuesi i parasë elektronike provon vërtetësinë e transaksionit, pastaj miraton dhe transferon shumën e parasë elektronike të përdorur. I gjithë ky proces kryhet në mënyrë elektronike.

Procesi ilustruhet në figurën:



emetuesi

hapja e
llogarisë

rregullatori

vërtetimi:
hapja e
llogarisë

klienti

tregtari

blerja

paraja



Pjesa teknike:

Si mundësohet paraja elektronike?

Paraja elektronike mundësohet nëpërmjet kriptografisë* dhe nënshkrimeve (firma) dixhitale. Do të duhej shumë kohë për të shpjeguar më në hollësi se si funksionojnë të dyja këto koncepte. Megjithatë, thelbi i tyre është që bankat dhe klientët kanë kode deshifrimi. Këto kode deshifrimi janë gjithmonë çift: një kod publik, i njohur vetëm nga klienti dhe një kod tjetër privat, i cili dihet dhe përdoret vetëm nga punonjësit e bankës që janë caktuar me këtë detyrë. Të gjithë informacionin që kodi privat kodifikon, kodi publik mund ta deshifrojë dhe anasjelltas.

Bankat dhe klientët përdorin kodet e tyre për të kodifikuar (për arsye sigurie) dhe për të nënshkruar (për arsye identifikimi) të dhëna numerike që përfaqësojnë urdhërpagesa. Një bankë “nënshkruan” këto urdhërpagesa, duke përdorur kodin e saj privat, i cili njihet vetëm nga punonjësi i bankës, ndërsa klientët verifikojnë urdhërpagesat e nënshkruara nëpërmjet kodit publik, i cili njihet nga punonjësi i bankës dhe klienti. Klientët nënshkruajnë depozita dhe tërheqin para duke përdorur kodin e tyre publik ndërsa banka përdor kodin publik të klientit, për të verifikuar tërheqjet dhe depozitat e nënshkruara.



paraja elektronike mundësohet nëpërmjet kriptografisë*

*Shkenca e analizimit dhe deshifrimit të kodeve, shifrave dhe kriptogrameve.



A ekzistojnë lloje të ndryshme të parasë elektronike?

Në përgjithësi, dallohen dy lloje të parasë elektronike: ajo e cila mund të identifikohet dhe paraja elektronike e paidentifikueshme (anonime). Paraja elektronike e identifikueshme përmban informacion mbi identitetin e personit, i cili ka tërhequr paratë nga banka. Paraja e identifikueshme i jep mundësi bankës “të gjurmojë” paratë, teksa qarkullon nëpër ekonomi. Për shembull, kur paguani diçka duke përdorur një kartë krediti, banka është në gjendje të identifikojë pagesën e kryer dhe në këtë mënyrë, mund të reduktojë shumën e paguar nga llogaria juaj bankare. Paraja elektronike anonime funksionon njësoj si paraja *cash*. Në momentin që paraja elektronike anonime tërhiqet nga banka nëpërmjet një llogarie bankare, ajo shndërrohet në para *cash* (para prej letre) dhe mund të shpenzohet pa lënë asnjë gjurmë të transaksionit të kryer.



lloje të
parasë elektronike

E lehtë për të blerë
E lehtë për të paguar



E lehtë PËR TË BLERË
E lehtë PËR TË PAGUAR

Përparësitë e parasë elektronike

Ashtu si paraja prej letre, paraja elektronike të krijon mundësinë të blesh të mira dhe shërbime, të japësh borxh dhe ta marrësh atë. Komoditeti është përparësia kryesore që ofron paraja elektronike. Ajo zëvendëson nevojën për të mbajtur me vete para *cash*. Këto para, tashmë janë në formën e një llogarie bankare ose të një karte krediti, në pritje për t'u tërhequr apo përdorur nga konsumatori. Një tjetër lehtësi që ofron kjo para është dhe kursimi i kohës për të shkuar në bankë, dhe për të tërhequr para apo për të kryer transferta të shumave të ndryshme. Gjithashtu, paraja elektronike në ndryshim nga paraja letër, është e padëmtueshme sepse ajo nuk griset, nuk laget dhe nuk priset me kalimin e kohës.

Me krijimin e parasë elektronike shumë banka kanë nxjerrë produkte të ndryshme në treg, nëpërmjet të cilave të gjithë kanë mundësi të transferojnë fonde nga një llogari bankare në tjetrën, të blejnë artikuj të ndryshëm në internet, të paguajnë faturat e ujit, të dritave, të telefonit etj..

Disavantazhet e parasë elektronike

Me gjithë të mirat që ofron paraja elektronike, ajo ka edhe disavantazhet e saj. Disa prej tyre përfshijnë mashtrimin, dështimin e teknologjisë dhe pasigurinë që u jep njerëzve.

Një prej shqetësimeve më të mëdha është që falsifikatorët mund të krijojnë llojin e tyre të parasë elektronike, e cila do të ishte e padallueshme nga paraja e vërtetë. Këto probleme duhet të merren parasysh, në mënyrë që të fitohet besimi i publikut. Rritja e pakontrollueshme e përdorimit të parasë elektronike mund të vërë në rrezik sistemet e kontrolluara të parasë, duke i dhënë kështu dorë të lirë sistemeve joefikase. Në një sistem të pakontrolluar pagesash elektronike, pastrimi i parasë dhe evazioni fiskal mund të përhapen me shpejtësi. Kështu, është e rëndësishme që autoritetet të monitorojë qarkullimin e parasë, për të zbuluar këto aktivitete të paligjshme.

Nga ana tjetër, transaksionet nëpërmjet parasë elektronike janë pothuajse “të padukshme” në sytë e njerëzve, krahasuar me transaksionet, të cilat kryhen në para *cash*. Duke mos patur mundësi t’i shohin këto transaksione në momentin që ato kryhen, njerëzit kanë tendencën të kenë një ndjenjë pasigurie për to.

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të përmbledhur avantazhet dhe disavantazhet e parasë elektronike, sipas aktorëve kryesorë në sistemin e pagesave elektronike.




Tabelë 1. Avantazhet dhe disavantazhet e parasë elektronike.

Aktorët kryesorë	Efektet pozitive	Efektet negative
Rregullatorët	Më e kontrollueshme në momentin e kryerjes së transaksionit	Nuk lë gjurmë Evazion fiskal Kudër rregullator në lëvizje
Emetuesit	Tregje të reja dhe fitimprurëse	Falsifikim
Klientët	Më praktike në përdorim	Mungesë e mbrojtjes së anonimitetit të klientit
Tregtarët	Hyrje në tregjet globale Efikasitet në veprime	Falsifikim



EMV-Ready



TDK
www.tdksemiconductor.com

© TDK Semiconductor Corp.
All rights reserved.

Përdorimet në jetën e përditshme të parasë elektronike

Paraja elektronike tashmë është pjesë e pandashme e jetës së përditshme. Ajo kalon nga një bankë në tjetrën, nga një komisioner tek tjetri dhe nga njëri shtet në një shtet tjetër.

Shembulli i përdorimit të parasë elektronike në jetën e përditshme janë kartat e kreditit dhe ATM-të. Nuk është e çuditshme që ka njerëz, të cilët tërheqin paratë e tyre nëpërmjet ATM-ve dhe nuk u ka qëlluar pothuajse asnjëherë që të hyjnë në një bankë.

Sportelet automatike ose siç njihen ndryshe ATM-të, kanë filluar të shfaqen në vitet '70. Këto sportele janë në gjendje të kryejnë një sërë transaksionesh rutinë për klientët e bankës. Disa prej këtyre transaksioneve janë: tërheqja e parave, marrja e informacionit mbi gjendjen e llogarisë bankare, transfertat e parave ndërmjet llogarive të ndryshme bankare etj.. Avantazhi më i madh që ATM-të i ofrojnë klientëve është që ato janë të hapura 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Ndërsa për bankat, avantazhi i përdorimit të ATM-ve është se ato janë shumë ekonomike për llojet e transaksioneve që kryejnë.

Përveç ATM-ve, një tjetër metodë në të cilën paraja elektronike gjen përdorim të përditshëm, është edhe pagesa e faturave të ndryshme me anë të kartave.



Përdorimet
në jetën e përditshme
të parasë elektronike



Paraja elektronike në Shqipëri

Historia e parasë elektronike në Shqipëri fillon në vitin 2003, me hapjen e një numri të vogël të ATM-ve (sporteleve automatike). Sot, një pjesë e mirë e bankave që operojnë në Shqipëri kanë krijuar një rrjet të zgjeruar ATM-sh në Tiranë dhe në disa qytete të tjera. Vitet e fundit është rritur numri i përdoruesve të ATM-ve, nga 34,090 në rreth 295,250. Kjo, ka ardhur si rezultat i kalimit të pagës së buxhetorëve nëpërmjet rrugëve bankare. Megjithë hezitimin nga një pjesë e nëpunësve të administratës publike, tashmë të gjithë punonjësit e kësaj administrate paguhen nëpërmjet llogarive, në bankat e nivelit të dytë. Si rrjedhojë, tërheqja e pagave nëpërmjet këtyre llogarive është kthyer në një veprim shumë të zakonshëm.

Rritja e numrit të përdoruesve të parasë elektronike në Shqipëri ka qenë paralele me rritjen e transaksioneve në rrugë bankare. Kështu, është vënë re një rritje e madhe përsa i përket kartave të kreditit, të cilat nga 806 që ishin në vitin 2004 janë shtuar në 4,245. Përsa i përket kartave të debitit dhe atyre *cash*, ato janë shtuar respektivisht nga 6,552 në 70,176 dhe nga 26,736 në vitin 2004, në 220,657 në vitin 2006.

Paraja elektronike
në **Shqipëri**



Botime edukative të Bankës së Shqipërisë

Duke e konsideruar publikun si një hallkë të rëndësishme në procesin e transmetimit të vendimeve të saj, Banka e Shqipërisë përgatit një sërë botimesh edukative me tema të ndryshme, disa prej të cilave po i rendisim:

Borxhi dhe kredia = një çështje interesi

Borxhi ka ekzistuar që në kohët e mesjetës dhe deri në ditët tona. Ai ka marrë forma të ndryshme duke u zhvilluar në atë që ne e njohim sot me emrin kredi. Kjo broshurë informon publikun mbi format e ndryshme të kredive dhe si mund të aplikohet për një të tillë.

Në pritje të regjistrimit të kredive

Duke pritur që edhe Shqipëria të ketë Regjistrin e saj të parë të Kredive, Banka e Shqipërisë publikon këtë broshurë, e cila synon t'i shpjegojë publikut se çfarë është një regjistër kredie, si funksionon ai, ç'loj informacioni përmban dhe mbi të gjitha përse krijimi i tij është një domosdoshmëri për situatën aktuale shqiptare.

Departamentet në Bankën e Shqipërisë

"Departamentet në Bankën e Shqipërisë" i ribotuar, ju sjell informacion të rinovuar mbi disa ndryshime të bëra në Bankën e Shqipërisë, ndërkohë që risjell në vëmendjen e të gjithëve, një prezantim të bërë edhe më parë mbi detyrat dhe funksionet tashmë të konsoliduara, të pjesës tjetër të Bankës.

Përse duhet të keni një buxhet personal?

Buxheti mund të konsiderohet si hapi i parë për të arritur qëllimet tuaja financiare. Ai ju ndihmon të kontrolloni shpenzimet tuaja, duke krijuar mundësi që të shtoni kursimet. Në një farë mënyre buxheti është ndërgjegjja juaj financiare. Ai tregon se sa fitoni dhe sa jeni duke shpenzuar.

Bankat qendrore të rajonit

Nëpërmjet një rrëfimi copëzash të historive të bankave të rajonit tonë, kjo broshurë synon të japë një panoramë të përgjithshme të asaj çka bën një bankë qendrore. Bankat janë si njerëzit: kanë jetët e historitë e tyre tipike, kuriozitetet, të thënat e të pathënat, rriten, ndryshojnë, transformohen, zhvillohen, kanë veçoritë e tyre që i dallojnë nga njëra-tjetra, por në thelb mbeten të njëjta.

Ç'është për ju stabiliteti i çmimeve?

Kjo broshurë përshkruan në mënyrë të thjeshtë dhe të detajuar qëndrueshmërinë e çmimeve dhe rëndësinë e saj për ekonominë e një vendi. Në tekst, do të gjeni shembuj të cilët janë marrë nga jeta e përditshme. Kjo broshurë shpjegon edhe konceptet e inflacionit e të deflacionit dhe ndërlikimet që ato sjellin në jetën e secilit.